

LIGJ
Nr. 18/2012

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, nënshkruar më 19 shkurt 2008.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7331, datë 8.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE, TË NËNSHKRUAR MË 19 SHKURT 2008

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (më tej të referuara si “Palët”),

me dëshirën për të thelluar më tej marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë;

në përputhje me nenin 12 të marrëveshjes për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të nënshkruar më 19 shkurt 2008;

me qëllim për të lehtësuar më tej regjimin e lëvizjes së ndërsjellë të shtetasve të Palëve,

kanë rënë dakord që marrëveshja për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e cila ka hyrë në fuqi nga 27 gushti 2008, të ndryshohet si vijon.

Neni 1

Në nenin 1, paragrafi 1, fjala “ose” që ndjek fjalën “shërbimi”, do të zëvendësohet me fjalën

“dhe” dhe fjalët “karta identiteti biometrike të vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “pasaporta kombëtare”.

Në të njëjtin nen, paragrafi 2, fjalët “ose karta identiteti biometrike të vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “dokumente udhëtimi”.

Neni 2

Në nenin 4, fjalët “një periudhë më e gjatë kohe” do të hiqen dhe fjalët “për më tepër se 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh” do të shtohen pas fjalëve “në territorin e Palës tjetër Kontraktuese”.

Neni 3

Në nenin 9, një presje dhe fjalët “kartë identiteti biometrike” do të shtohen pas fjalëve “dokumente të përshtatshme udhëtimi”.

Neni 4

Në nenin 10, paragrafi 1, fjalët “dhe kartë identiteti biometrike e vlefshme” do të shtohen pas fjalëve “dokumente udhëtimi të vlefshme”.

Në të njëjtin nen, paragrafi 2, fjalët “ose karta identiteti biometrike” do të shtohen pas fjalëve “një model i ri i dokumentit të udhëtimit”.

Neni 5

Në pikën 1 të shtojcës së marrëveshjes të shtohet teksti: “h) karta identiteti biometrike” pas pikës “g”.

Në pikën 2 të shtojcës të shtohet teksti: “g) kartë identiteti biometrike” pas pikës “f”.

Neni 6

Kjo marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që ndryshon Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, e nënshkruar në Tiranë më 19 shkurt 2008, do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, ku palët informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë plotësuar kushtet ligjore për hyrjen në fuqi.

Bërë në Tiranë, më 14.12.2011, në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, maqedonase, angleze, të gjitha tekstet të vlefshme në mënyrë të barabartë. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.